



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 554/2 prot.,

Datë 06.03.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-94268-01-31-2024, me objekt: “*Blerje Asfalti*” me fond limit 37.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

Ankimues: “Ruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK me NUIS J629042640, me adresë: Fshati Balez Poshte, zona kadastrale nr.1079, nr.pasurise 322/11, 1 km nga kryqezimi i fshatit Kusar, Elbasan.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kavajë me adresë: Bulevardi “Josif Budo”, Kavajë

Në datën 05.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 554/2024 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3864 e operatorit ekonomik “Ruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-94268-01-31-2024, me objekt: “*Blerje Asfalti*” me fond limit 37.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 554 prot., datë 05.03.2024.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Oferta juaj per tenderin REF-94268-01-31-2024, me objekt Blerje asfalti eshte refuzuar:

1. Nga verifikimi I kryer per dokumentat e tenderit te paraqitura ne SPE dhe ne shtojces 8 (vetedeklarim) operatori ekonomik RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN ne Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit A: DEKLARATË Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës: Deklarata Përgjigje Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. Po [] Jo [X] Ne vetedeklarimin e operatori ekonomik RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN , shenja eshte vene te JO, duke vetedeklaruar se nuk I ploteson te gjitha specifikimet teknike sic udhezohet ne dokumentat e tenderit dhe nuk marrin persiper te realizojne objektin ne perputhje me Listen e mallrave dhe grafikun e levrimit te percaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Te gjendur perballe kesaj deklarate oferta juaj refuzohet.

2. Nga verifikimi I kryer ne shtojces 8 (vetedeklarim) RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN nuk ka paraqitur 2 kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton, 2 automjetet e paraqitura jane Koka terheqese + gjysmerimorkio qe nuk plotesojne kushtin kamiona me 4 akse. Si pasoje OE SHKELQIMI 07 nuk ka permbushur piken 2.3.2 praragrafi 3 , pasi ka paraqitur 1 nga 3 kamiona vetëshkarkues me 4 akse me kapacitet mbajtës minimumi 25 (njëzetepesë) ton. ”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 06.03.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri